



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 138, datë 13.03.2024

**PËR
DËRGIMIN E EMRIT TË KANDIDATIT I CILI KA APLIKUAR PËR T’U
KOMANDUAR NË POZICIONIN “NDIHMËSMAGJISTRAT”
NË GJYKATËN E LARTË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e tij nr. 68, datë 15.02.2024, si dhe pas vlerësimit të kërkesës së gjyqtarës znj. {...},

V E N D O S I

1. T’i dërgohet Gjykatës së Lartë emri i znj. {...}, e cili ka aplikuar për t’u komanduar, “ndihmësmagjistrat” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë, si dhe praktika dokumentare e paraqitur prej saj.
2. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

OPINION

MBI

**KANDIDATËT QË KANË APLIKUAR PËR T’U KOMANDUAR
NË GJYKATËN E LARTË**

I. Hyrje

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 79, shkronja “b”, dhe 86, shkronja “d”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 8, 53, 54, 56, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me vendimin nr. 68, datë 15.02.2024 ka vendosur: “1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit Gjykatën e Lartë. 2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën e Lartë për 4 (katër) pozicione “ndihmësmagjistrat” në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë.
2. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim deri në datë 01.03.2024.
3. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka paraqitur kërkesë vetëm 1(një) kandidate.
4. Me shkresën nr. 1290, datë 27.02.2024, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Znj. {...} ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në Gjykatën e Lartë, për pozicionin “ndihmësmagjistrat”.
5. Në vendimin nr. 68, datë 15.02.2024 të Këshillit, konkretisht në Kreun II të tij, është përcaktuar edhe procedura që do të ndiqet nga Këshilli.
6. Konkretisht në pikën 11, Kreu II të këtij vendimi parashikohet “11. Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nga komandimi kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai

ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.”

7. Në pikat vijuese të këtij Kreu parashikohet procedura e mëtejshme që ndiqet: “12. Këshilli i Lartë Gjyqësor, i përcjell menjëherë për vlerësim Gjykatës së Lartë emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit për pozicionin e ndihmësmagjistratit, dokumentacionin e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre. 13. Gjykata e Lartë vlerëson aplikimet e kandidatëve dhe i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e magjistratit që ka përzgjedhur. 14. Brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit, të kandidatit të përzgjedhur nga Gjykata e Lartë.
8. Gjithashtu në këtë vendim është parashikuar edhe rasti kur asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet e komandimit ose kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet nga Gjykata e Lartë, pas njoftimit dhe mbi kërkesën e kësaj të fundit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rihap procedurën e komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.

II. Vlerësimi i Komisionit

9. Në respektim të procedurës që duhet të ndiqet sipas vendimit nr. 68, datë 15.02.2024 të Këshillit **në fazën e parë**, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin.
10. Në këto rrethana Komisioni i Zhvillimit të Karrierës harton Projekt-opinionin për kandidaten znj. {...}.
11. Në përgatitjen e këtij opinionit për këtë kandidate, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, verifikon, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kushtet ndaluese si dhe vlerëson cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtari që ka paraqitur kërkesën për komandim.

i. Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit.

Kandidatja {...}

12. Kriteret e komandimit përcaktohen në nenin 53, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Po ashtu kriteret të posaçme përcaktuar në pikën 8, Kreu II të Vendimit të Këshillit nr. 156, datë 29.03.2023. Konkretisht, në këtë pikë të këtij vendimi përcaktohet se: “Kriteret e komandimit janë:
 - a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
 - b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
 - c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;

- ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:
 - i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
 - ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;
- d) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- dh) Kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare, me anëtarët e Gjykatës së Lartë, kancelarin, anëtarët e tjerë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

12.1 Lidhur me kriteret e komandimit sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 8, të vendimit të sipërcituar të Këshillit, sipas informacionit të marrë, nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në të dhënat e dosjes personale të kandidates, rezulton se:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 13.07.2013 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2023.

Me vendim nr. 573, datë 12.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar.

Me vendim nr. 596, datë 19.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 4 muaj.

Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

12.2 Lidhur me kriteret e komandimit - *kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale* – znj. {...} ka nënshkruar vetëdeklarimin datë 27.02.2024 sipas të cilit: “*Nuk do të ndodhem në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Gjykatës së Lartë, kancelarin, anëtarët e tjerë të Njesisë së Shërbimit Ligjor, sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”*”

13. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatja {...} dhe dokumentet në dosjen personale rezulton se plotësohen kriteret e komandimit.

14. Në këto kushte, për këtë gjyqtare, nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

i. Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesi të lartë) të gjykatës

15. Sa i përket cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesi të lartë) të gjykatës ku kandidatja ushtron funksionin, - Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, mendimi i është marrë zëvendëskryetares së kësaj gjykate. Në opinionin e saj janë përfshirë edhe 2 gjyqtare të tjera përkatësisht znj. Thomaida {...} dhe znj. {...} të cilat kanë aplikuar për pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin”

në Këshill dhe “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese. Në këtë opinion parashtrohet se:

“... Në përgjigje të kërkesës për dhënie mendimi ju bej me dije se, magjistratet znj. {...} dhe znj. {...} janë pjesë e seksionit civil të gjykatës Elbasan, e cila aktualisht ka 5 gjyqtarë, sepse një gjyqtare është me leje lindje. Nëse do të komandoheshin të dyja gjyqtaret atëherë vlerësoj se do të cenohet funksionaliteti i gjykatës. Gjykatë e cila ka qenë pothuajse në gjendje kolapsi për shkak se në Shtator 2023 mbeti me tre gjyqtarë.

Komandimi i tyre do të na detyronte të shkrimin seksionet dhe mbi të gjitha gjyqtarët do të mbingarkoheshin me dosje. Ju bëj me dije që jemi nën presion të vazhdueshëm të publikut, mediatik, por dhe të institucioneve për shkak të vonesave në gjykim dhe arsyetim. Mendoj që komandimi i njëres apo të dyja gjyqtareve përkatësisht në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese do të cenonte funksionalitetin e Gjykatës Elbasan, të cilës edhe aktualisht i mungojnë në organikë 5 gjyqtarë.

Në lidhje me gjyqtaren {...} ju bej me dije se gjyqtarja {...} i përket seksionit penal. Mesa jam në dijeni është në proces plotësimi i një vendi vakant në Gjykatën Elbasan në fushën penale. Ndonëse ngarkesë kemi edhe në seksionin penal, nëse paralelisht me komandimin e gjyqtarës {...} do të plotësohej vakanca në gjykatë që është në proces, komandimi i saj në Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk do të cenonte funksionalitetin e gjykatës.

I kërkoj Këshillit të Lartë Gjyqësor që të mbajë në vëmendje gjendjen në të cilin ndodhet gjykata e Elbasanit për shkak të ngarkesës, por edhe pozitën e gjyqtarëve të cilët ushtrojnë detyrën në këtë gjykatë prej vitesh, përpara se të vendosë për komandime të gjyqtarëve të kësaj gjykate në gjykatat më ta larta.”

16. Komisioni për të analizuar funksionalitetin e gjykatës ka marrë të dhëna edhe ngarkesën përkatëse të gjykatës JP Elbasan, të përcjellë nga kjo gjykatë pranë sektorit të Statistikave dhe Arkivës Gjyqësore në Këshill.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

Nr.	Gjyqtari	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme	Nr. çështjeve të regjistruara të reja (nga data 01 janar)	Nr. çështjeve të gjykuara	Nr. çështjeve në shqyrtim
1.	{...}	437	702	695	316
2.	{...}	484	402	245	0
3.	{...}	763	943	852	378
4.	{...}	568	1049	859	438
5.	{...}	552	633	399	0
6.	{...}	579	860	495	0
7.	{...}	0	80	103	505

8.	{...}	0	81	57	499
9.	{...}	0	80	131	510
10.	{...}	0	82	69	331
11.	{...}	0	83	45	322
12.	{...}	0	85	63	333
13.	{...}	0	86	193	321
14.	{...}	0	85	95	380
	TOTALI	3383	5251	4301	4333

17. Sa i përket Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, situata është komplekse. Nga kjo gjykatë kanë aplikuar për komandim 3(tre) gjyqtare: znj. {...}, për pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë; znj. {...} {...} në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Këshill; dhe znj. {...} e cila ka aplikuar në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën Kushtetuese. Në këto rrethana mbajtur në vëmendje numrin e gjyqtarëve që ushtrojnë aktualisht funksionin në këtë gjykatë (11 nga 18 që janë në strukturën e kësaj gjykate), mundësohet komandimi vetëm për 1(një) magjistrat. Për të përcaktuar magjistratin, komandimi i të cilit prek më lehtë ose aspak funksionalitetin e gjykatës, Komisioni merr në analizën ngarkesën e secilit magjistrat dhe natyrën e çështjeve që ka në shqyrtim. Znj. {...} është pjesë e seksionit civil dhe ka në shqyrtim **322** çështje; znj. {...} {...} është pjesë e seksionit penal dhe ka në shqyrtim **505** çështje; znj. {...} është pjesë e seksionit civil dhe ka në shqyrtim **331** çështje. Nga këto statistika rezulton se ngarkesa e znj. {...} është më e ultët se koleget e tjera që kanë kandiduar për komandime; ngarkesa e znj. {...} është dukshëm shumë më e lartë krahasuar me dy magjistratët e tjera; nga ana tjetër znj. {...} është pjesë e seksionit penal, ku gjykon çështje me karakter urgjent e tepër urgjent. Siç parashtron edhe zëvendëskryetarja e gjykatës për një pozicion të lirë të shpallur për lëvizje paralele në fushën penale, (pozicioni nr.252/2023) procedurat mund të përfundojnë shpejt nga ana e Këshillit. Por, në eventualitetin e komandimit të znj. {...} zëvendësimi i gjyqtarit në çështjet penale mund të sjellë pasoja për procesin, sa i përket afateve të paraburgimit, ashtu edhe drejtim të zgjatjes së afatit të afatit të arsyeshëm, aq më tepër kur në çështjet penale preken të drejtat dhe liritë themelore të personit. Për sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} {...}, do të passjell cenim të interesave të larta të gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për sa kohë funksionaliteti i saj do të dëmtohet. Ndër dy magjistratet e tjera të cilat kanë aplikuar për komandim në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, vërehet se znj. {...}, pjesë e seksionit civil ka ngarkesë më të ulët, e për pasojë komandimi i saj nuk do të dëmtonte interesat e Gjykatës së Shkallës së Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1.1 T’i dërgohet Gjykatës së Lartë emri i znj. {...}, e cila ka aplikuar për t’u komanduar, në pozicionin “ndihmësmagjistrat” në Gjykatën e Lartë, si dhe praktika dokumentare e

paraqitur prej saj në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të saj.

- 1.2 Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS